

**KËRKESA ËSHTË PUBLIKE.**

DHOMËS SË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

Hagë

Për

PËR ORGANIN – PANELIN APO KRYETARIN KOMPETENT PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT  
TË ADMINISTRATORES DR. FIDELMA DONLON

Z. Ruzhdi Saramati  
Fshati Dobrushtë, komuna Prizren  
20000 Prizren  
Kosovë

Datë 22.02.2019

Ref: KSC/REG/IOR/1632

KRYETARES TË DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

Hagë, Holandë

Kundër Vendimit Ref: KSC/REG/IOR/1632 të Administratores Dr. Fidelima Donlon të datës 18 shkurt 2019 me të cilin është refuzuar ndihma juridike falas për të dyshuarin Ruzhdi Saramati duke konstatuar se nuk i plotëson të gjitha kriteret formale në kërkesën për caktimin e mbrojtësit dhe për ndihmë juridike, I dyshuari Ruzhdi Saramati nga fshati Dobrushtë, komuna e Prizrenit në afatin e caktuar parashtron

**KËRKESE PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT**

**A r s y e t**

Me vendimin Ref: KSC/REG/IOR/1632 datë 18.02.2019 për refuzimin e ndihmës juridike falas dhe për caktimin e avokatit mbrojtës, Administratorja Dr. Fidelma Donlon gabimisht e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në këtë ka marr vendim jo ligjor.

Theksoj se në bazë të kërkesë sime si i dyshuar Ruzhdi Saramati i kam plotësuar të gjitha kushtet për fitimin e të drejtës për ndihmë juridike falas dhe caktimin e avokati mbrojtës e kjo vërtetohet në bazë të të gjitha provave të cilat iu kanë bashkëngjitur Shkresave për vendosje nga Administratorja Dr. Fidelma Donlon, si organ i shkallës së parë të vendosjes.

Në këtë arsyetoi se vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike qëndron në të gjitha pikat në bazë të së cilës është marrë vendim refuzues për kërkesën lëndore dhe në këtë theksoj si në vijim:

**1. Unë si i dyshuar Ruzhdi Saramati i kam dhënë të gjitha informacionet të besueshme dhe të vërtetuara lidhur me 3 llogaritë të cilat i kam të vetmet në qarkullimin tim bankar, përkatësisht për 2 llogaritë bankare të shënuara në Formularin e deklarimit.**

Administratorja Dr. Fidelma Donlon gabimisht i ka lexuar apo interpretuar ngase unë ja kam dërguar 3 llogari bankare në të cilat janë edhe raportet për këto llogari (2) të deklaruara në formularin e deklarimit të mjeteve financiare dhe në atë janë të precizuara se cili Raport është për cilën llogari bankare si dhe jua kam dërguar edhe llogarinë e tretë me Deklarimin bankar.

**Llogaria tjetër bankare nuk kam** por gabimisht janë interpretuar llogaritë e mija bankare të cilat me kartelë bankare janë të bashkëngjitura kërkesë për ndihmë juridike falas e të cilat edhe herën e parë ja kam parashtruar por Administratorja Dr. Fidelma Donlon me apo pa qëllim i ka interpretuar në mënyrë të gabuar duke theksuar se dy llogaritë bankare nuk janë arsyetuar e ndërsa ato 2 llogari bankare edhe sot janë aktive në Bankat përkatëse e për të cilën jua kam parashtrua edhe Deklarimet e mjeteve bankare dhe të njëjtat i keni në shkresat e lëndës tek Administratorja Dr. Fidelma Donlon.

Prandaj ju lutem kontrolloni me vëmendje dhe ato dy llogaritë janë në bashkëngjitje me deklaratat bankare për secilën llogari disponuese si dhe për llogarinë e tretë bankare, **ndaj i kam vetëm tri llogari bankare në të cilat derdhen mjetet dhe ato: të 1. pensionit i validor, 2. pensionit të Gjermanisë dhe 3. pensionit të TMK.**

**2. Nuk qëndron gjendja faktike se ju kam informuar gabimisht për llogari tjera bankare** por në dy llogaritë bankare në të cilat dyshoni (e që nuk qëndron) ju kam shtuar edhe llogarinë e tretë bankare. **Kështu që i kam vetëm 3 llogari bankare e në dyshim mund të vërtetohen në bankat përkatëse telefonat e të cilëve jua kam dërguar dhe kam kërkuar që ta vërtetoni se i kam vetëm 3 llogari bankare e tëi cilat gjenden në shkresat e kërkesës për ndihmë.**

**3. Nuk qëndron gjendja faktike se nuk e kam dhënë informacionin për automjetin** ngase nuk është kërkuar nga Administratorja Dr. Fidelma Donlon automjeti për tu deklaruar, e në kërkesën e Administratores Dr. Fidelma Donlon plotësisht e kam dërguar informacionet për automjetin posedues.

Prandaj Kryetare e Gjykatës së Specializuar, duke pritur për ti studiuar më thellë dhe verifikuar vërtetësinë e provave në rast dyshim nga organet kompetente telefonat e të cilëve jua kam bashkëngjitur, provat e bashkëngjitura me një refuzim të tillë formal i cili ligjërisht nuk mund të qëndroj më është refuzuar kërkesa për ndihmë juridike falas si dhe për avokat mbrojtës.

Në fund Ju lutem ta rishikoi kërkesë time nga aspekti jo vetëm formal por edhe material në bazë të dokumentacionit i cili është kërkuar dhe të cilin jua kam dërguar në tërësi dhe do të bindeni se kërkesa e ime është e arsyeshme për ndihmën e kërkuar juridike falas dhe për avokat mbrojtës dhe se në këtë do të marrë përgjigje pozitive.

Dobrushtë,  
22.2.2019

Me respekt, i dyshuari,  
Ruzhdi Saramati